

Jo negociata sepse...

- Jo negociata sepse negociatat kanë kuptim kur zhvillohen mes palëve të barabarta. Kosova nuk është e barabartë me Serbinë. Kosova nuk është shtet sikur Serbia.
- Jo negociata sepse nuk janë zhbërë strukturat e Serbisë në Kosovë.
- Jo negociata sepse përveçqë Kosova e ka Serbinë në qafë, ajo e ka edhe UNMIK-un mbi kokë. Kosova sundohet nga regjimi antidemokratik i UNMIK-ut.
- Jo negociata sepse institucionet e sistemit që i ka krijuar dhe i kontrollon ky regjim, medoemos do të udhëhiqen prej njerëzve të korruptuar e të shantazhuar, të tillë çfarë janë sot në Kosovë.
- Jo negociata sepse përmes negociatave Serbia po tenton të përligj ambiciet e saj për të rivendosur kontrollin faktik mbi popullin dhe territorin e vendit tonë, madje duke bërë edhe ndarjen e tij.
- Jo negociata sepse ato po planifikohen për Kosovën, e jo edhe për Serbinë. Rezoluta 1244 do të jetë baza e negociatave, e, siç dihet, rezoluta 1244 e ruan nominalisht sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën dhe e nxit restaurimin faktik të tij.
- Jo negociata sepse negociatat nuk planifikohen të bëhen për të kërkuar përgjegjësi dhe dëmshpërblim nga Serbia për 12.000 të vrarë, 3.000 të rrëmbyer, 20.000 femra të dhunuara, një milion të dëbuar dhe 120.000 shtëpi të shkatërruara. Negociatat po parashikohen të bëhen për të kurorëzuar rehabilitimin e shtetit të Serbisë.
- Jo negociata sepse negociatat përfundimisht do ta barazojnë krimin dhe gjenocidin (shteti i Serbisë) me viktimën (populli i Kosovës); dhe, agresionin me luftën çlirimtare.
- Jo negociata sepse negociatat duhet të zhvillohen pa kushte. Vendi ynë po kushtëzohet: na janë vënë standarde për të plotësuar dhe parime të panegociueshme arbitrare.
- Jo negociata sepse Serbia nuk u identifikua si agresor që ushtroi represion e terror për më se një shekull, por madje ajo pas rënies së Milosheviqit u rehabilitua; automatikisht (pa plotësuar standarde) u pranua në institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë.
- Jo negociata sepse Kosovës nuk i mungon statusi, por popullit të saj i mungon liria. I burgosuri nuk negocion.
- Jo negociata sepse ato pashmangshëm nënkuptojnë gatishtërinë për kompromis. Liria nuk është kompromis. Liria është e drejtë e pandërmjetësuar dhe gjendje e panegociueshme.
- Jo negociata sepse fillimi i negociatave paraqet fundin e pavarësisë dhe shtetësisë si mundësi. Serbisë i mjafton kjo, në mënyrë që pastaj negociatat të bëhen për autonominë territoriale të serbëve në Kosovë e që nënkupton legalizimin e enklavave ekzistuese serbe në Kosovë si dhe zgjerimin e tyre dhe krijimin e enklavave të reja. Një gjë e tillë veç ka filluar me decentralizimin.
- Jo negociata sepse me Serbinë mund të negociohet për shumëçka tjetër vetëm atëherë kur ajo të pranojë parakushtin e panegociueshëm – vullnetin e popullit të Kosovës.